24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

   Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

   a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

   b) garanci bankare;

   c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

   Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin perfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

   a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

   b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

   c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

   d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3:Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca: 8: Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE[4]

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*)**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ---------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ---------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

[4] Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE[5]

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*)**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë:

[5] Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

1	2	3
Nr.	**Përshkrimi i mallrave**	**Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret "oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët", autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	*2*	*3*	*4*	*5*	
Artikulli	**Përshkrimi i mallit**	**Sasia**	**çmimi per njesi**	**Çmimi total për artikull (*3* x *4X*)**	
1.					
2.					
3.					
4					
				Çmimi total (Mallrat)	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efiçencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike për të dy lotet hanë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Spitali Universitar i Traumës si më poshtë:

Specifikimet teknke janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues Spitali Universitar i Traumës (SUT) bazuar në specifikimet teknike të unifikuara nga Organi Qendror Blerës, të publikuara në faqen zyrtare të Operatorit Blerjeve të Përqendruara www.obp.al, dt 07.05.2025 ne perputhje me nevojat e SUT dhe ne menyre qe te perputhen dhe pershtaten me ambjentin ku ato do te montohen. Per artikujt të cilat nuk janë gjendur në katallogët e publikuar në OBP, grupi i punës ka hartuar specifikimet në përputhje me kërkesat e shërbimeve mjekësore në SUT duke marë parasysh ambjentet dhe llojin e shërbimit që ofrohet për pacientët dhe personelin mjekësor. Certifikimet dhe cdo kërkesë tjetër është marrë duke u bazuar në artikujt e ngjashëm në katallogët e miratuar (për artikujt që kërkohen certifikime). Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SECILIN LOT

LOTI 1: "MOBILJE DHE PAJISJE PËR PËRDORIM ZYRE DHE AMBJENTE TË TJERA"

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. **Recepsion në formë U-je**

Ky recepsion modern përmban sipërfaqe të rimesuar. Trashësia e pllakës MDF të përdorur është 17 mm. Syprina ndërtohet me material MDF me trashësi 25 mm, lyerja ngjyrë gri metalizato që përputhet me xogolaturën e mobiljes. Ballorja të ndërtohet me material MDF e rimesuar 17 mm. Katër unaza metalike gjenden në sipërfaqe për të mbajtur telat/kabllot të fshehura dhe të organizuara. Karakteristika unike e kësaj tryeze është suprina e xhamit të temperuar që duket se noton mbi sipërfaqe dhe mbështetet nga këmbëza prej metali ngjyrë argjendi. Kjo tryezë përbëhet nga dy tavolina të drejta 120 cm, dy tavolina të harkuara dhe një kthim tavolinë kthimi që mund të vendosen në të dy anët. Mobilja e recepsionit të jetë e pajisur me sirtarë. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3 sirtarë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të pajisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës.
Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN,e një vlefshme ose e përditësuar),SSH EN 13721:2004
-Tavolinat e drejta: Min 120x80x105c m
-Tavolina me hark: Min 80x80x105cm
-Tavolina e kthimit Min 80x80x75 cm,
- Dimensione: Min 280x200x105 cm Max 300x220x120 cm

2. DOLLAP MEDIKAMENTESH ME XHAM

Kabineti me strukturë bilaminate. Struktura është bërë tërësisht nga bilaminat (trashësia 20mm) me buzë të bardha ABS. Ana e pasme në bilaminat.
Ndarja e brendshme është e pajisur me 4-5 rafte të rregullueshme të bëra nga dy ndarje bilamineti.
Dyert jane me celes dhe janë bërë nga bilaminat i bardhë me buzë ABS dhe janë furnizuar me 4 mentesha me të paktën Hapja 270 °. Pjesa e brendshme e secilës derë e pajisur me ndarje fikse prej polistireni termoformuar, përfshirë këtu 10 ndarje (dimensioni i përafërt me një ndarje: 35x10x15cm).
Baza e pajisur me këmbët e bëra nga tuba çeliku, të lyera epoksi, me hekura plastike.
Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 100 x 60 x 200 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

3. RAFT PËR DOSJE (ETAZHER)

Skeleti dhe sergjenet do jenë prej materiali pllake zdrukthi të melaminuar me trashësi 18 mm. Kapakët janë me material MDF me trashësi 18 mm të borduar me PVC me trashesi 0.8 mm. Xokola do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njejtit material. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore plastike kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë, që mbyllen me çelës.

Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy hapesira me anë të një sergjeni me lartësi të regjistrueshme.
Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami (që mund të jenë me ose pa kornizë druri). Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës.
Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali të kromuar. Shpina e mobiljes me fiber 4 mm trashësi.
Permasat: 90 x 45 x 190 cm
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015.
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

4. RAFT PËR DOSJE, MATERIAL MDF

Raftet do të realizohen me MDF, ku në pjesën e dukshme ajo do të jetë të veshur me rimeso druri si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me llak transparent me ngjyrë natyrale. Pjesa e poshtme do të jetë me kapakë me MDF me lyerje deri në lartesinë 75 cm dhe do të ndahet hapësira me anë të një sergjeni. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 18 mm. Dorezat do të realizohen me frezim. Duhet të kihet kujdes në montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit.

Në pjesën e poshtme do të vendosen tapa fundore plastike me lartësi 3 cm në kontaktin me dyshemenë. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me MDF me lyerje me trashësi 7 mm. Pjesa e sipërme do të jetë me kanata prej xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm.
Xhami do jetë transparent me trashësi 4 mm. Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës.
Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar.
Përmasat: 90 x 45 x 200 cm
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

5. RAFT PËR BIBLIOTEKËN

Materiali pllake druri i shtresuar (multistrate) 18 mm trashësi. Librari e lartë, realizuar me 2 thellësi. Pjesa e poshtme, do të ketë strukturë anësore me trashësi 18 mm, me përmasa: lartësi 1060 mm, gjerësi 810 mm dhe thellësi 610 mm. Duhet të ketë tre hapësira që realizohen nëpërmjet dy ndarëseve.
Xokola do jetë 8 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material. Shpinorja të jetë e dukshme me trashësi 7 mm. Në mes të strukturës, për të lejuar sistemimin e librave, duhet të jetë e pajisur me një ndarëse vertikale.
Pjesa e sipërme, me përmasa: lartësi 1540 mm, gjerësi 810 mm, thellësia 505 mm. Duhet të jetë e pajisur me tre ndarëse horizontale. Materiali i librarisë duhet të jetë në dru i shtresuar, me lyerje me llak në ngjyrë natyrale, gjithashtu i trajtuar kundër lagështirës dhe reflektimit të dritës.
Raftet e brendshme janë të pajisur me element mbajtës të padukshme, të cilët ndihmojnë në qëndrimin e strukturës anësore, duke balancuar peshën në momentin e mbushjes me libra apo materiale të tjera zyre.

Përmasat: Gjerësi 81cm; Lartësi 260 cm; Thellësi 50.5/61 cm

Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

6. DOLLAP ME DY KANATA

Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm. Kanatet do të montohen me mentesha me thithje.
Sergjenet do jenë prej materiali pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira me sergjene me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi.
Permasat: 90 x 45 x 210 cm
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

7. KOMO ME PASQYRË

Materiali do të jetë pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm, në të gjitha anët do të jetë e veshur me një shtresë PVC me trashësi 0.8 mm.
Komoja do të ketë 4 sirtarë të cilët mbështeten mbi shina me thithje duke bërë të mundur me lehtësi lëvizjen tyre. Pjesa e mbrapme e komosë dhe fundi i sirtareve do të jetë me fibër 4 mm.
Pasqyra do të vendoset në një kornizë me pllake zdrukthi te melaminuar në përmasa 90 x 90. Dorezat dhe shinat e përdorura të jenë cilësore.
Përmasat: 90 x 55 x 80 cm
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

8. DOLLAP RROBASH PËR ZYRA (NJË KANAT)

Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore t ë dukshme të skeletit dhe kanatit të jenë borduara me material plastik PVC me trashësi 0.8 mm. Kanati të ketë mbyllje me çelës.
Kanatet do të montohen me mentesha me thithje . Në pjesën e brendshme të ketë tub për varjen e rrobave dhe ndarje që formojnë dy hapësira në pjesën e poshtme.
Xokola do të jetë 8 cm e lartë me po të njëjtin material si skeleti. Të jetë i pajisur me tapa plastike kundër gërvishtjes. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi. Aksesor ët e p ërdoru r t ë jenë cilësorë .
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015
Dimensionet: 45 x 55 x 200 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

9. MOBILIE QE MONTOHET NE MUR, ME NDARJE DHE CELESA

- Përmasat (gjatësi x thellësi x lartësi):

Min: 120 x 40 x 180 cm Max: 180 x 50 x 200 cm. Sipas kerkeses se AK.

- Konfigurimi:

Ndarje në formë kubike
Numri i ndarjeve:
9 ndarje (3x3)
Çdo ndarje: Min 35 x 35 x 35 cm

- Karakteristikat kryesore:

Rafti të jetë me ndarje të hapura për vendosjen e:
- Ushqimeve te personelit
- Sendeve të vogla

Strukturë e qëndrueshme dhe e fiksuar
Lehtë për pastrim dhe dezinfektim
Skaje të rrumbullakosura për siguri
Mundësi për etiketim (numërim ndarjesh)
- Materiali:

MDF i veshur me melaminë antibakteriale
Laminat rezistent ndaj lagështirës dhe dezinfektuesve. Bordim me PVC (2 mm)
- Elementë shtesë:

Bazë e ngritur nga toka (10–15 cm)
Mundësi fiksimi në mur
Ngjyra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor
Montim dhe çmontim i thjeshtë
Materiale rezistente ndaj dezinfektuesve spitalorë
Sipërfaqe jo-poroze dhe antibakteriale
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

10. <u>Tavolinë pune në formë L-je + Komodinë</u>

Tavolina e punës: Suprina pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm. Komodina përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali pllakë zdrukthi e melaminuar 18 mm, ngjyra të jetë e njëjtë me tavolinën.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).

Përmasat: Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x h-72 cm Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 160 x 70 x h-68 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

11. TAVOLINË PUNE

Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 36 mm. Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinëstë jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 210 x 75 x 80 cm

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

12. TAVOLINË PUNE + KOMODINE

Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plan të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm.

Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinëstë jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Komodina përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali pllake zdrukthi e melaminuar 18 mm , ngjyra të jetë e njëjtë me tavolinën.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)

Përmasat:

Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): *Min 115 x 70 x 72 cm Max 120 x 75 x 77 cm*

Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm - *Max 50 x 70 x h-75 cm*

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

13. TAVOLINË PUNE E THJESHTË

Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës, e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës.

Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)

Përmasat: 140 x 80 x 75 cm

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

14. TAVOLINË E VOGËL MBLEDHJESH

Syprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës (suprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).

Përmasat: 180 x 105 x 75 cm

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

15. TAVOLINË PUNE RANG DREJTUESI, MATERIAL MDF

Tavolina e punës do të realizohet me MDF, ku në pjesën e jashtme do të jetë e rimesuar me rimeso me rimeso anigre dhe do të lyhet me llak transparent dhe pigment druri sipas kodit përkatës. Tavolina do të jetë e përbërë nga dy pjesë, ku në njërën pjesë suprina e tavolinës do të jetë me përmasa 190 x 80 cm, lartësia e tavolinës nga toka 76 cm dhe pjesa e sirtarëve me dimensione 210*60*60 cm. Suprina e tavolinës dhe faqet anësore do të kenë spesor 17 mm, të cilat në faqen e jashtme do të jenë të rimesuar me rimeso anigreje. Faqja ballore, e cila ka kanelura, do të ketë spesor 17 mm dhe kjo do të jetë e rimesuar me rimeso anigreje dhe e lyer me llak transparent. Profilet do të jenë strukturë metalike prej çeliku, me profile 50 x 20 mm, të punuar në të ftohtë ose këmbë me funde të rrotullueshme. Lyerja do të jetë realizuar me fushe elektrostatike dhe të ofrojë rezistencë të shkëlqyer kundër gërvishtjes, fërkimit dhe ndryshkjes. Elementet e sirtarëve do të jenë të rimesuar me rimeso anigreje dhe të lyer me llak transparent, ndërsa pjesa e brendshme e sirtareve do të jetë e realizuar me pllakë zdrukthi te melaminuar

të bardhë. Duhet të kihet kujdes në montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
Përmasat: 190 x 80 x 76 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

16. TAVOLINË MESI

Materiali i përdorur do të jetë MDF e rimesuar me lyerje me llak. Suprina në pamjen ballore të saj do të jetë 10 cm. Këmbët e tavolinës përbëhen nga i njëjti material me atë të suprinës dhe janë të përmasave 10 x 10 x 35 cm. Ato montohen në skajet e suprinës së tavolinës dhe duhet të garantojnë një qëndrueshmëri të lartë, sidomos në rrëshqitje.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
Përmasat: 110 x 55 x 45 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

17. TAVOLINË TELEVIZORI

Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm.
Tavolina qëndron mbi 4 këmbë metalike me lartësi 5 cm dhe të pajisura me mekanizëm nivelues. Në 15 cm poshtë suprinës kemi një ndarëse horizontale që shërben për mbajtjen e videos ose të pajisjeve të tjera. Pjesa e mbetur poshtë mbyllet me dy kapakë xhami të bombarduar jo i tejdukshëm.
Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015
Përmasat: 80 x 45 x 50 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

18. TAVOLINË E VEÇANTË PËR SALLË MBLEDHJESH

Suprina pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC me trashesi 0.8 mm.. Bashkimi i planit të punës(suprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Suprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë. Dy elementë me përmasa 180 x 80 cm që vendosen paralelisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. Dy elementët e

tjerë janë në përmasa 170 x 85 cm dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004
Përmasat: 350 x 170 x 75 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

19. TAVOLINË MENCE

Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të suprinës të jenë të rrethuara me material plastik PVC me trashesi 0.8 mm. Mbështetet në 4 këmbë prej çeliku me profil jo më të vogël se 30 x 30 mm, të cilat janë të pajisura me këmbëza niveluese. Ato lidhen me njëra tjetrën me traversa të po të njëjtit material. Të gjitha pjesët metalike janë të lyera me bojë elektrostatike me qëndrueshmëri të lartë ndaj ndryshkjes dhe gërvishtjeve.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023
Përmasat: 80 x 80 x 75 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

20. TABELË DRURI PËR TË VARUR SHËNIMET (E MBYLLUR)

Thellësia e brendshme 2.5 cm e këtij dollapi 180 x 120 cm do të thotë se është e lehtë të montosh njoftime. Veshjet elegante prej alumini sigurojnë një mënyrë tërheqëse dhe të qëndrueshme për të kornizuar informacionin dhe njoftimet tuaja të rëndësishme.
Dera me mbyllje me çelës përmban panel akrilik transparent rezistent dhe siguri. Rubber-Tak është një sipërfaqe me strukturë unike e prodhuar nga gomë të ricikluar për të siguruar qëndrueshmëri të pakrahasueshme. Vrimat e kunjve praktikisht zhduken në sipërfaqen e vetë-shërimit, e cila është gjithashtu rezistente ndaj njollave. Goma është rezistente ndaj lagështirës, rezistente ndaj kimikateve dhe nuk do të mbështesë rritjen e mykut ose baktereve. Paneli akrilik i qartë rezistent ndaj copëtimit. Zgjidhni midis mbështjellësve prej gomë-tak, tapë natyrale ose vinili.
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015
Përmasat:
Min 180x7.5 D x120 "H cm
Max 190x8.5 D x130 "H cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

21. MOBILJE PER KUZHINE

Mobilje për kuzhinë me të dyja pjesët (lart dhe poshtë) ku përshtatet lavamani i inkastruar, frigoriferi, etj. Në pjesën e poshtme duhet te jetë me kanata të mbyllura dhe nje bllok sirtaresh. Mobilja është me pllaka me baze druri të përpunuar të veshur me laminat lehtësisht e pastrueshme. Suprina është e plotë me trashësi 4 cm me një prapavijë të përshtatshme me lartësi 10 cm, lavaman inox me një rubinet me levë të vetme. Struktura dhe ndarjet e brendshme dhe kanatat janë të përbërë nga pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 18 mm, të veshura me ngjyrë druri ose ngjyrë tjetër, që mund të vendoset në kushtet e lidhjes së kontratës. Kapaket material MDF me trashësi 18 mm, me ngjyrën që mund të vendoset në kushtet e lidhjes së kontratës. Pjesa e poshtme mbështetet në këmbë plastike 10 cm që mbulohet me xokole me veshje alumini. Në pjesën e sipërme (me lartesi 72 cm dhe thellesi 35 cm) të vendoset një mbajtëse pjatash ne raftin mbi lavapjatë. Dorezat janë në formë paralepipedi prej materiali metal ngjyrë argjendi. Të gjitha kanatat janë të vendosura me mentesha me thithje. Pjesa e mbrapme e moduleve dhe fundet e sirtareve do të jetë me fibër 4 mm.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1116 : 2018, EN 16121:202.
Dimensionet: Min 400x85x75 cm Max 410x90x80 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

22. MOBILJE ME 2 SIRTARE PER LAVAMANE

Dollapi është bërë prej druri të përpunuar të veshur me laminat lehtësisht e pastrueshme.
Dollapi bazë ka një syprine të plotë të trashë 3cm me një prapavijë të përshtatshme me lartësi 10cm, , një sirtar ruajtjeje dhe dy kanata me një raft. Struktura dhe ndarjet e brendshme janë të përbërë nga panele mdf me trashësi 20mm të veshura me melamine ngjyre druri. Kanatat kapen me mentesha metalike me hapje deri 110°.
Dorezat janë në formë paralepipedi prej materiali polipropileni ngjyre argjendi, Të gjitha kanatat janë të varura në mentesha të cilësisë komerciale
Karakteristikat:
Menteshat e dyerve me cilësi komerciale
Sirtar i madh për ruajtje
Përmasat: Min 90x60x75cm
Max 100x70x85cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

23. KARRIGE LABORATORI

Karriget kërkohen të jenë rrotulluese, me ndenjëse mundësisht të rrumbullakët, me shpinore të ulët rreth 15 cm mbi nivelin e ndenjëses, me nivelim të rregullueshëm për ulje ngritje, me mbajtëse rrethore metalike për vendosjen e këmbëve dhe rrota të vendosura në këmbëzat për lëvizje.
Lartësia minimale dhe ajo maksimale do të jenë 44-54 cm. Materiali i ndenjëses është me mbushje sfungjeri dhe veshje sintetike, pjesa tjetër material metalik.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 1729- 1:2015/AC:2016, EN 1729-2:2023 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

24. <u>KARRIGE MENCE</u>

Karriget të jenë dizenjuar me një stil modern me skelet metalik prej tubash çeliku me profil rrethor me φ 21 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.3 mm të harkuar dhe lyer me bojë elektrostatike. Shpinorja dhe ndenjësja janë me kompensate, të cilat montohen në skeletin metalik me vida ose preçina.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 1729- 1:2015/AC:2016, EN 1729-2:2023 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
Përmasat: Ndenjësja:39 x 39 cm gjerësi, Shpinorja: 18 x 41 cm, Lartësia e karriges: 77 cm, Lartësia e ndenjëses 44 - 46 cm.
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

25. <u>KARRIGE PËR RANGUN DREJTUES</u>

Karrigia statike duhet të jetë me tapiceri prej lëkure ekologjike , me shpinore të lartë dhe rezistente ndaj zjarrit. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore me tub inoksi. Thellësia e ulëses, e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik me 5 degëzime në formë ylli.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

26. <u>KARRIGE STATIKE ME KRAHË MBËSHTETËS</u>

Të përgjithshme: Karrige pritje, fikse. Pjesa e pasme dhe ulja, përfshirë pjesa e pasme, janë plotësisht tapiceri. Këmbët metalike janë monokrormatike

Dimensione: Min 50x60x70cm Max 55x65x75cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

27. <u>KARRIGE PËR NGRËNIE</u>

Karrige me pjesën e pasme dhe ndejtësen e bërë nga materiali plastik polipropilene

Dimensione: Min 59x57x44/83cm Max65x62x49/88cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

28. KARRIGE JOSTATIKE ME KRAH MBESHTETES

Pesha rreth 12 kg, lartësia e shpinores jo më e vogël se 90/107 cm, lartësia e ndenjëses jo më e vogël se 45/52 cm, thellësia jo më e vogël se 44 cm, gjerësia jo më e vogël se 58 cm.
Me 5 rrota me bazën plastike me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komfort, e veshur me copë ose lëkurë, me regjistrues lartësie për tu ngritur dhe ulur karrigen.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13351:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

29. KARRIGE STATIKE PA KRAHË MBËSHTETËS

Karriget të jenë dizenjuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq ovale 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 mm, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësen. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Lyerja me fushë elektrostatike.
Tapiceria të jetë lëkurë ekologjike.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

30. STOL RROTULLUES ME RREGULLIM LARTESIE

Ndenjëse e veshur me lëkurë ekologjike cilësore, ngjyrë e zezë, rregullimi i lartësisë jo më pak se 560 në 790 mm me anë të sustës së gazit, me komandimin e unazës së këmbës. Me rrota plastike dyshe antistatike me diametër jo më pak se 50 mm dhe parakolp të zi rrethor.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-2:2018
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

31. KOLLTUQE KOMPLET (3+2+1)

Skelet druri, stil modern dhe tapiceri me lëkurë ekologjike. Mbushje me sfungjer cilësor. Modeli, seti, ngjyra, etj, do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës. Në komplet do të jenë një 3 vendesh një 2 vendesh dhe një kolltuk tek.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 16139:2013, EN 16139:2013/AC:2013
Përmasat:
Divani 3- vendësh: 200x90xH90 cm;
Divani 2- vendësh: 170x90xH90 cm;
Kolltuku: 120x90xH90 cm;
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

32. POLTRON PRITJE DYVENDËSH (KOLLTUK DYVENDËSH)

Të jetë me skelet druri. Të jetë i dizenjuar me linja të drejta të stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 16139:2013, EN 16139:2013/AC:2013
Përmasat: 186 x 95 x 94 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

33. PASQYRË MURI PËR TUALET

Xhami i pasqyrës të jetë i cilësisë së lartë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Montimi sipas kërkesave të AK-ve. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.
Përmasat: 80 x 60 cm, të jenë me korniza druri.
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

34. VARËSE RROBASH

Koka duhet të jetë e pajisur me 5 ganxha mbajtëse dhe 5 varëse të harkuara.
Diametri rrethor bazamenti mbajtës D: 48- 50 cm;
Boshti metalik L: 175-180 cm;
Diametri i boshtit metalik: minimumi 5 cm;
Mbajtëse për çadrat diametri: 27 cm me 4 vende
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

35. KREVAT TEK

Materiali i përdorur do jetë pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të rrethuara veshura me material plastik PVC 0.8 mm. Krevati do të jetë i pajisur me elementë druri të stazhionuar për mbajtjen e dyshekut. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1725:2023
Krevati 190 x 90 cm;
Koka e krevatit me përmasa: 80 x 90 cm;
Fundi i krevatit me përmasa: 40 x 90 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

36. <u>PERDE ME SHINE</u>

Të përgjithshme: Shinë plastike e kapur në tavan me cengela për kapjen e perdes. Shina vendoset përreth hapësirës së krevatit.

Materiali: Shinë plastike, perde poliester 100%

Dimensione: E barabartë me lartësinë nga dyshemeja në tavan minus 5cm nga tavani i përfunduar në majë dhe 20cm mbi dyshemenë e përfunduar.

Gjatesia Min 200 cm Max 250 cm Lartesia Min 200 cm Max 250cm

LOTI 2: "**MOBILJE DHE PAJISJE PËR PËRDORIME SPITALORE"**

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1.DOLLAP METALIK ME DYER

Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Përbëhet nga dy kanata me hapje 90 gradë.
Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira.
Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg.
Trashësia e llamarinës jo më pak se 0.9-1 mm
Dimensionet: 92 x 40 x 195 cm
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015.
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

2.RAFT METALIK PËR ARKIVË

Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x me spesor 1.5 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për vendosjen (sergjenat) e dosjeve do të jetë llamarinë e zezë me spesor 1.2 mm.
Rafti do të ketë dhe një platformë melamine me shinë që do të shërbejë për një shikim të shpejtë të dosjes në vend.
Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015
Përmasat: 100 x 42 x 250 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

3.RAFTE METALIKE

Skeleritë metalike të jenë prodhime cilësore dhe solide me material hekur "L". Materiali "L", të jenë prej hekuri cilësi e parë, me spesor jo më të vogël se 4 mm dhe gjerësi 40 mm. Këmbët të jenë 12 cm nga toka, ndarëset (sergjenet) të jene çdo 50 cm të salduara në mënyrë që të mbajnë pesha të mëdha. Shtresat e sergjenet të jenë prej llamarine me trashësi jo më pak se 1.2 mm e cilësi e parë, e punuar me forma që të mbajë peshën e shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë sergjenin, jo më pak se 120 kg.

Hapësirat të jenë me përmasa 100 x 50 cm x 60 cm thellësi. Raftet të realizohen sipas përmasave të kërkuara dhe te kenë vrima të hapura për të krijuar mundësitë që të lidhen me njëri – tjetrin me vida dhe bulona. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

Përmasat: 100 x 60 x 250 cm

4.GARDEROBË PËR PERSONEL (2 PËRDORUES / 1 NJËSI)

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):
Min: 80 x 50 x 180 cm dhe Max: 100 x 60 x 200 cm
Karakteristikat kryesore të produktit:

- Garderoba të jetë e ndarë në 2 seksione vertikale të pavarura (1 njësi = 2 persona)

Secili seksion të ketë:

- Derë të veçantë me mbyllje me çelës
- Hapësirë për varëse rrobash
- Raft të sipërm për sende personale
- Hapje ergonomike e dyerve (si në foto – me prerje të pjesshme për akses)
- Ventilim natyral (vrima ose grila ajrimi në pjesën e sipërme/poshtme)
- Mundësi për vendosje numri identifikimi për çdo përdorues

Materiali:

- Strukturë metalike (çelik)
- Lyerje me bojë epoksi elektrostatike antibakteriale
- Rezistente ndaj lagështirës dhe dezinfektuesve

Aksesoret:

- 1 shufër metalike për varëse në çdo seksion
- 2–3 varëse rrobash
- 1 raft sipër
- Brave me çelës (ose opsionalisht me kod)
- Doreza inox ose alumini

Elementë shtesë:

- Bazë me këmbë plastike ose metalike (10–15 cm nga toka për pastrim)
- Mundësi për fiksim në mur për stabilitet
- Sipërfaqe e lëmuar për pastrim të lehtë

Standardi ku bazohet:
- Rezistencë ndaj dezinfektuesve spitalorë
- Material antibakterial sipas standardeve spitalore
- Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

5.RAFTE PER DHOMAT E PASTRA

Raftet janë me material çeliku inoks, dhe pastrohen lehtësisht. Duhet te mbaje ngarkesa te larta dhe këmbët janë te rregullueshme. Rafti duhet te jete me ndarje me hapësirë min 50 cm .
Dimensionet: Min 180x50x200 cm Max 190x55x210 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

6.RAFTE INOKSI

Të përgjithshme: Sistemi i rafteve përbëhet nga vetë struktura mbajtëse me 4 rafte të bëra nga fletë çeliku pa tehe të mprehta dhe armatura qendrore. Kapaciteti i ngarkesës në raft: minimumi 160 kg .
Materiali: Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)
Dimensione: Min 100x50x198cm Max 110x60x205cm
Imazhe:
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese
.

7.TAVOLINË PUNE LABORATORI ME LAVAMAN

Tavoline pune inoksi me lavaman. Pjesa e poshtme e tavolines eshte e mbyllur dhe me ndarje. Celik inoks sipas standartit AISI 304 **.** Lavamani furnizohet i plotë me kullues, sifon, lidhje fleksibël me rrjetin e ujit dhe prizat për montim në mur.
Dimensionet :Gjatesi Nga 240 deri 260 cm

Dimensionet :Gjeresi Nga 85 deri 95 cm
Dimensionet : Lartesi Nga 75 deri 100 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

8.TAVOLINE INOKSI ME 4 RROTA

Materiali Inoks AISI 304. Diametri i kembeve min 100 mm me 4 rrota rrotulluese ku 2 nga rrotat me frenim. Struktura duhet te jete e ndashme dhe pjesa e siperme INOX AISI 304 me poliuretan me dendesi te larte dhe panel te brendshem. Tavolina duhet te kete 2 sirtare me permasat e sirtareve 47x30x12 cm nga secili krah ne menyre qe te punohet nga te dyja anet e tavolines.
Dimensionet: Min 90x40x80cm Max 100x50x90cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

9.TAVOLINË PËR INSTRUMENTA

Të përgjithshme:
Kanalet përforcuese të mbyllura sigurojnë ngurtësi strukturore
Këmbët me diametër 3cm janë ngjitur plotësisht për fortësi dhe qëndrueshmëri
Rafti i poshtëm me thellësi 40cm për ruajtje shtesë
Montuar mbi 4 rrota rrotulluese me diametër 7cm (2 bllokues, 2 pa bllokues)
Materiali: Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)
Dimensione: Min 76x40x86 cm Max 80x50x90 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

10.MAYO INTRUMENTESH

Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi):
- Tabaka (sipërfaqja):

Min: 60 x 40 cm
Max: 75 x 50 cm
- Lartësia e rregullueshme:

Min: 80 cm
Max: 120 cm
Karakteristikat kryesore:
- Tavolina të jetë e tipit Mayo stand, e përshtatshme për sallë operacioni
- Të ketë rregullim lartësie (manual ose hidraulik/gaz)
- Tabakaja të jetë:
  - e lëvizshme

• me skaje të ngritura për të parandaluar rrëshqitjen e instrumenteve
- Bazë me 4 rrota rrotulluese, minimumi 2 me frenim
- Strukturë e qëndrueshme dhe balancuar për përdorim gjatë ndërhyrjeve
- Lehtë e manovrueshme dhe e përshtatshme për ambiente sterile

Materiali:
- Çelik inoks AISI 304 (material standard për sallë operacioni)
- Sipërfaqe:
• rezistente ndaj dezinfektuesve spitalorë
• antikorrozive
• e lëmuar për pastrim të lehtë
- Mekanizmat metalikë të jenë rezistentë ndaj përdorimit intensiv

Struktura:
- Kolonë mbajtëse vertikale me sistem rregullimi
- Bazë në formë "U" ose "H" për stabilitet maksimal
- Rrota antistatike, rezistente ndaj kimikateve
- Materiali sipas standardit AISI 304

Elementë shtesë:
- Lëvizje e qetë pa zhurmë

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

11.KARROCË INOKSI ME 2 GROPA DHE SIRTARE

Karroce me 2 gropa, me sirtare dhe materiali inoks i cilesise se larte. Pastrohet lehtesisht.

Dimensionet e karroces Min 110x70x90 cm Max 120x75x95 cm

Permasat e sirtarit: Min 30 x 65 x 9 cm Max 40 x 70 x 15 cm

Diametri i gropes Min 35 cm Max 45 cm

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

12.KARROCË PËR MBAJTËSE ILACESH

Të përgjithshme: - Strukturë Inox ose alumin me lyerje me bojë epoksi per rezistencë ndaj detergjentëve dhe dezinfektantëve.
- Pjesa e sipërme e sipërme ABS / Inox ose alumin
- Doreza shtytëse anësore
- Baza ABS / Inox ose alumin
- Sirtaret me sistem mbyllje automatik, 110% total i hapjes
- Mbajtësi i kartës së identifikimit, me ngjyrë të bardhë
- 2 rafte me 8 kosha shpërndarës ilace 230x120x70mm
- Shportat e ilaceve me ndarës transparent dhe mbajtës të kartës së identifikimit
- Bllokohet me çelës
- Rrota me diam. 100 mm, dy prej tyre me frena

Dimensione: Min 78x46x97cm Max 83x51x102cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

13.KARROCË ME RROTA PËR PAJISJE STERILE

Të përgjithshme: Njësia për mbajtjen e mjeteve sterile mund të vendoset kudo që kërkohet. Përmban tre madhësi sirtarësh me ndarës specifik për ruajtjen e lehtë të sendeve, p.sh. Komplete gastroskopi, pajisje, instrumente, etj.
Njësia për furnizimet sterile mbyllet me një rul (qepen) që zbret nga lart dhe është me celes sekret. Vendoset mbi 4 rrota me diam. 125 mm dhe përmban elementet në vijim:
Organizimi i brendshme te jete i ndare me sergjene.
Materiali është metalike të lyer me baze epoksi. Të pastrohet me një agjent dezinfektues, jo me një kimikat të bazuar në klor.
Dimensione: Min 60cm x 60cm x 175cm Max 70cm x 70cm x 185cm.
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

14.KARROCË PËR SHËRBIM EMERGJENTE

Të përgjithshme: Një karrocë për emergjencë është një dollap me rrota ose sirtarë i cili përmban të gjitha pajisjet e nevojshme për reanimacion, nga dorezat e latexit deri te defibrilator (sipas modelit ne foto pa përfshire pajisje mjekësore)
Trupi i dollapit me 2 sirtarë, poshtë ndarjes së hapur me panel çeliku të poshtëm, përfshirë. shufra e infuzionit, raft magazinimi.
- Bllokimi qendror
- Barrierë anësore
- Fiksim për bombolat e oksigjenit
- Bordi i Reanimacionit
- Dalja e katër prizave

Kabineti: Ndërtim sanduiç me metal të plotë vetë-mbështetës, dizajn me dy mure, tingull i amortizuar, i izoluar nga mbrojtja termike. Ngarkesa e sigurt e punës: minimumi 20 kg.
Dorezat e shiritave: Diecast zinku, rezistent ndaj kimikateve, me shtresë antimikrobike në vermilionin RAL 2002. Pjesa e sipërme e tryezës pa nyje e bërë nga ABS, me buzë të ngritura, e mbyllur në pjesën e poshtme.
Veshje antimikrobike në dorezat e sirtarëve dhe shiritin udhëzues
Përmasat min max: Gjerësia: 60 cm-65 cm, Thellësia: 50cm-60 cm, Lartësia (deri te sipërfaqja e punës): 80cm-90 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

15.KARROCE INOKSI ME 2 GROPA

Të përgjithshme: Kapaciteti 8 litra / lavaman
• Dy rafte
• Dy prej tyre mund të bllokohen gjithsej katër rrota
Materiali: Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)
Dimensione: Min 60x60x90cm Max 70x65x100cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

16.KARROCË FURNIZIMI

Të përgjithshme: Karrocë e lëvizëshme me rrota prej çeliku inoks me 3 rafte të brendshëm fikse.
Materiali: Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)
Dimensione: Min 95x55x70 cm Max 105x65x80 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

17.STOL PER DHOMAT E NDERRIMIT

Stolat e dhomave të ndërrimit me listela druri me seksion 2,5 x 5cm dhe strukturë hekuri. Stol i përbërë nga strukturë prej profili hekuri me seksion 40 x 20mm, raft i poshtëm për pushimin e këpucëve po me ristela druri me seksion 1,5 x 5cm

Dimensione Min 100x40x45cm Max 110x50x55 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

18.STOL PRITJE 2 VENDESH

Materiali: Inoks. Ngjyra: Do të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, Kapaciteti i mbajtës 325-350 kg. Pjesë të qëndrueshme me lidhje të salduara, gjë që rrit jetën dhe stabilitetin e stolit.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 12727:2016.
Stoli 2 vendësh përmasat: Min 107x66x78 cm Max 115x70x83 cm;

19.STOL PRITJE 3 VENDESH

Materiali: Inoks. Ngjyra: Do të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, Kapaciteti i mbajtës 325-350 kg. Pjesë të qëndrueshme me lidhje të salduara, gjë që rrit jetën dhe stabilitetin e stolit.
Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 12727:2016.
Stoli 3 vendësh: Min 178x66x78cm Max 183x70x83cm;

20.SHKALLË NDIHMËSE PËR NGJITJEN NË KREVAT

Gjatësia: 70 cm Gjerësia: 37 cm
Lartësia e hapit të parë: 18 cm Lartësia e hapit të dytë: 36 cm
Materiali: Kornizë çeliku me veshje pluhuri; sipërfaqe antirrëshqitëse
Kapaciteti mbajtës: Deri në 150 kg Pesha: Rreth 6.2 kg
Ngjyra: E bardhë me hapa të zinj
* Karakteristikat Kryesore
- Dy hapa për ngjitje më të lehtë dhe të sigurt. Të vendoset poshtë krevatit
- Gjatësi 70 cm për përshtatje më të mirë poshtë krevatit
- Konstruksion i fortë dhe i qëndrueshëm
- Sipërfaqe antirrëshqitëse për siguri maksimale
- I përshtatshëm për përdorim në ambiente spitalore
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

21.MOBILJE INOXI PLUS LAVAMAN INOXI ME 2 GROPA

Të përgjithshme:
Lavamani me dy gropa dhe 1 ose 2 rubineta. Materiali ne inoks.
Lavamani furnizohet i plotë me kullues, sifon, lidhje fleksibël me rrjetin e ujit dhe prizat për montim në mur.
Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)
Dimensione: Min 170x60x75cm Max 180x65x80cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese**.**

22.MOBILJE INOXI PLUS LAVAMAN INOKSI ME SIRTARE

Lavamani me 1 rubinet dhe 1 bombol me vrimë nxjerrëse të sapunit të lëngët, të kontrolluar nga pedale e pavarur. Materiali ne inoks.
Lavamani furnizohet i plotë me kullues, sifon, lidhje fleksibël me rrjetin e ujit dhe prizat për montim në mur.

Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.
Dimensionet: Min 100x65x85cm Max 140x70x90cm.
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

23.MBAJTËSË PËR VESHJE DHE DOREZA E LËVIZËSHME

Të përgjithshme: Varësja ka 4 rrota, 2 prej të cilave kanë një pedal-bllokues. Strukture e përshtatshme për të ruajtur përparëset dhe dorezat përshtatshëm për:
6 veshje
3 palë doreza
3 grupe syze
Materiali: Strukturë metalike lyer me epoksi
Dimensione: Min 70 x 50 x 200 cm Max 80 x 60 x 210 cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

24.STOL PER MRI

Stoli eshte jo magnetik. Shkeljet e shkalleve jane me shtrese gome.
Dimensionet: Min 100x60x110cm Max 130x80x160cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

25.STATIV

Të përgjithshme: Stativ INOKS 304.
Me rregullues lartesie jo me pak se 160-220 cm.
Diametri i tubit jo me pak se 2.5 cm.Pesha mbajtese min 2 kg.
Baza ne forme ylli Celik me 5 rrota.
Koka mbajtese e serumit plastike me 4 vende.
Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm)

Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

26.KARROCË PER PERSONA ME AFTESI TE KUFIZUAR

Të përgjithshme: Kjo karrige me rrota me gjeresi jo me pak se 50 cm është e ndërtuar tërësisht nga materiale jo prej hekuri dhe e projektuar posaçërisht për përdorim brenda ambienteve spitalore. Të gjitha materialet, duke përfshirë mbërthyesit dhe kushinetat, janë jo metale me ngjyra ose polimerë të veçantë.
Gjerësia e sediljes: Nga 55cm deri ne 60 cm
Gjerësia e përgjithshme: Nga 76cm deri ne 80 cm
Thellësia e përgjithshme: Nga 83cm deri ne 90 cm pa mbështetëse
Thellësia e sediljes: Nga 45cm deri ne 50 cm
Gjatësia e përgjithshme: Nga 96cm deri ne 100 cm
Lartësia e pasme: Nga 45cm deri ne 55 cm
Rrotat e përparme: Nga 20cm x 2.5cm deri ne 30 cm x 3.5 cm
Rrotat e pasme: Nga 60cm deri ne 70 cm
Karroca te jete e pajisur me frena
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

27.KOSH MBETURINASH - JO MAGNETIKE (MRI)

Të përgjithshme: Të për bërë nga inoks standart 304 jo-magnetik Funksionimi i kapakut me pedalin e këmbës. Përputhet me rregulloret e OBRA-s dhe standardet OSHA për patogjenët e transmetuar nga gjaku për përmbajtjen e sigurt të mbetjeve infektive
Përmasat: Min 35x35x60cm Max 45x45x70cm
Modelet e shembujve janë udhërrëfyese

28.KOSH MBETURINASH

Koshi përmban kapakun vet-mbyllës që fshehin mbeturinat nga pamja dhe bllokojnë aromat brenda. Ndërtuar nga çeliku rezistent ndaj shpimeve, i sigurt nga zjarri me shtresa të dyfishta bllokuese, kështu që do të mbajë pamjen e saj të mirë për vite me radhë edhe në mjedise me përdorim të lartë. Lyerja me epoksi të zi reziston ndaj gërvishtjeve.
Karakteristikat:
Kapak dykahëshe, vetë-mbyllëse
Rezistente ndaj shpimeve
Çelik i mbrojtur nga zjarri
Këmbë polietileni
Përfundimi i veshjes me pluhur epoksi
Përmasat: Min 35x35x60cm Max 45x45x70cm

LOTI 3: "BLERJE TELEVIZOR DHE FRIGORIFER"

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.FRIGORIFER I VOGEL (MINIBAR)

Kompresori: Universal
Tipi: Minibar
Kapaciteti total: jo me pak 100 L
Kapaciteti i ngriresit: jo me pak se 14 L
Klasi i energjisë: A++
Niveli i zhurmës: 41 dB
Paneli I kontrollit: Mekanik
Permasat ne cm jo me pak se (lartësi 85xgjeresi 55x thellësi 56)
Sistemi i ftohjes: Statik
Ndriçimi brendshëm: LED
Raftet: Xhami
Garancia: 24 muaj

2.TELEVIZOR

Madhësia e ekranin: 43"
Paneli: LED
Rezolucioni: 4K Ultra HD
Smart TV: PO
Wireless: Po
Bluetooth: Po
Marrësi: DV B-T/T2/C
Audio: 20 w (Dolby Digital)
HDMI/USB: PO
Ethernet: PO
I pajisur me mbajtëse ne mur: Po
I pajisur me mbajtëse për vendosje te lire: Po
Instalimi: I përfshire ne çmim
Garancia: 24 muaj

PËR TË GJITHA LOTET:

Shënim: Përmasat në tabelë do të kenë një tolerancë +/- 5% me qellim përshtatjen e mobiljeve sipas hapësirave të ambienteve në dispozicion të SUT.

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre. Në çdo rast për standardet e kërkuara do të pranohet edhe paraqitja e SSH/EN/ISO, të përditësuara për standardet ndërkombëtare të adaptruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit.

Shënim: Operatori Ekonomik qe do te shpallet fitues për këtë procedure, përpara se te prodhohen apo blihen mobiljet do te verifikohen ne vend dimensionet e dhomave ne mënyrë qe te përshtatet sa me mire mobilimi dhe te jete funksional.

Certifikimi
Çdo artikull mobilie duhet të dorëzohet së bashku me certifikimin e cilësisë, garancisë dhe sigurisë.
Siguria e dorëzimit dhe cilësisë
Mostra: Pas nënshkrimit te kontratës përpara se te vendosen artikujt ne objekt, kontraktuesi duhet të prezantojë mostra për zërat te cilat do të përzgjidhen / aprovohen nga Autoriteti Kontraktor.

Dorëzimi dhe Magazinimi:
Kontraktuesi duhet të minimizojë nevojën për magazinimin e mobiljeve në vendin e dorëzimit. Nuk do të lejohet magazinimi i mobiljeve në vendin e dorëzimit derisa të jetë dhënë aprovimi i AK se puna ka arritur përfundim dhe se artikujt objekt prokurimi nuk vihen në rrezik dëmtimi apo ndotje nga punime të tjera. Nëse magazinohen artikujt duhet të mbrohen nga dëmtimi dhe/ose ndotja, si dhe të ruhen në një ambient të sigurt.
Ngjyra e mobiljeve do te përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor përpara se te prodhohen apo blihen nga Kontraktuesi.

Specifikimet teknke janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues Spitali Universitar i Traumës (SUT) bazuar në specifikimet teknike të unifikuara nga Organi Qendror Blerës, të publikuara në faqen zyrtare të Operatorit Blerjeve të Përqendruara www.obp.al, dt 07.05.2025 ne perputhje me nevojat e SUT dhe ne menyre qe te perputhen dhe pershtaten me ambjentin ku ato do te montohen. Per artikujt të cilat nuk janë gjendur në katallogët e publikuar në OBP, grupi i punës ka hartuar specifikimet në përputhje me kërkesat e shërbimeve mjekësore në SUT duke marë parasysh ambjentet dhe llojin e shërbimit që ofrohet për pacientët dhe personelin mjekësor. Certifikimet dhe cdo kërkesë tjetër është marrë duke u bazuar në artikujt e ngjashëm në katallogët e miratuar (për artikujt që kërkohen certifikime). Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Shtojca 7.

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*
(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

LOTI 1: "MOBILJE DHE PAJISJE PËR PËRDORIM ZYRE DHE AMBJENTE TË TJERA"

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia matëse	Sasia e pritshme per 24 muaj
1	**Recepsion ne formë U-je** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Tavolinat e drejta: Min 120x80x105cm Tavolina me hark: Min 80x80x105cm Tavolina e kthimit Min 80x80x75cm, Dimensione: Min 280x200x105cm Max 300x220x120 cm	Copë	1
2	**Dollap medikamentesh me xham** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 100 x 60 x 200 cm*	Copë	31
3	**Raft për dosje (etazher)** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 190 cm	Copë	2
4	**Raft për dosje, material MDF** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 200 cm	Copë	19
5	**Raft për bibliotekën** Përmasat: L81 H 260 P 50.5/61 cm	Copë	1
6	**Dollap me dy kanata** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 210 cm	Copë	3
7	**Komo me pasqyrë** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90x 55 x 80 cm	Copë	1
8	**Dollap rrobash për zyra (një kanat)** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 55 x 200 cm	Copë	5
9	**Mobilie qe montohet ne mur, me ndarje dhe celesa per personelin**	Copë	2
10	**Tavolinë pune në formë L-je + Komodinë** Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x h-72 cm Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 160 x 70 x h-68 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm	Copë	10
11	**Tavoline pune** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 210 x 75 x 80 cm*	Copë	4
12	**Tavolinë pune + Komodinë** Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 115 x 70 x 72 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm	Copë	11
13	**Tavolinë pune e thjeshtë** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm	Copë	1
14	**Tavolinë e vogël mbledhjesh** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi):180 x 105 x 75 cm	Copë	1
15	**Tavolinë pune rang drejtuesi, material MDF** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 190 x 80 x 76 cm	Copë	1

16	**Tavolinë mesi** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 110 x 55 x 45 cm	Copë	4
17	**Tavolinë televizori** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 80 x 45 x 50 cm	Copë	1
18	**Tavolinë e veçantë për sallë mbledhjesh** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 350 x 170 x 75 cm	Copë	1
19	**Tavolinë mence** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 80 x 80 x 75 cm	Copë	2
20	**Tabelë druri për të varur shënimet (e mbyllur)**: Përmasat: Min 180x7.5 D x120 "H cm Max 190x8.5 D x130 "H cm	Copë	6
21	**Mobilje për kuzhinë** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 400x85x75 cm Max 410x90x80 cm	Copë	1
22	**Mobilje me dy sirtare per lavamane** Përmasat: Min 90x60x75cm Max 100x70x85cm	Copë	11
23	**Karrige laboratori**	Copë	52
24	**Karrige mence**	Copë	8
25	**Karrige për rangun drejtues**	Copë	5
26	**Karrige statike me krahë mbështetës** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 50x60x70cm Max 55x65x75cm*	Copë	31
27	**Karrige per ngrenie** Përmasat: Min 59x57x44/83cm Max65x62x49/88cm	Copë	12
28	**Karrige jo statike me krahë mbështetës**	Copë	9
29	**Karrige statike pa krahë mbështetës**	Copë	14
30	**Stol rrotullues me rregullim lartesie**	Copë	11
31	**Kolltuqe komplet (3+2+1)**	Komplet	2
32	**Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)**	Copë	3
33	**Pasqyrë muri për tualet** *Përmasa 80 x 60 cm*	Copë	21
34	**Varëse rrobash**	Copë	33
35	**Krevat tek** *Përmasat (gjatësi x gjerësi): 190 x 90 cm*	Copë	3
36	**Komplet perde (perde me shine)**	Komplet	24

Afatet e lëvrimit: Brenda 2 (dy) muajve duke filluar nga data e nënshkrimit të minikontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër me afat 24 muaj.

LOTI 2: "**MOBILJE DHE PAJISJE PËR PËRDORIME SPITALORE"**

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia matëse	Sasia e pritshme per 24 muaj
1	**Dollap metalik me dyer** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 92 x 40 x 195 cm	Copë	38
2	**Raft metalik për arkivë** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 42 x 250 cm	Copë	6
3	**Rafte metalike** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 60 x 250 cm	Copë	3
4	**Garderobe per personel (2 perdorues / 1 njesi)** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi) Max: 100 x 60 x 200 cm*	Copë	119
5	**Raft për dhomat e pastra** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 190 x 55 x 210 cm*	Copë	21
6	**Rafte inoxi** *Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 110 x 60 x 205 cm*	Copë	4
7	**Tavoline pune laboratori me lavaman** *Dimensionet: Gjatesi Nga 240 deri 260 cm* *Dimensionet: Gjeresi Nga 85 deri 95 cm* *Dimensionet: Lartesi Nga 75 deri 100 cm*	Copë	2
8	**Tavoline inoksi me 4 rrota** Përmasat: *Min 90x40x80cm Max 100x50x90cm*	Copë	25
9	**Tavoline per instrumenta** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 80 x 50 x 90 cm*	Copë	21
10	**Mayo intrumentash** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 75 x 50 x 120 cm*	Copë	33
11	**Karroce inoxi me 2 gropa dhe sirtare**	Copë	10
12	**Karroce per mbajtese ilacesh** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 83 x 51 x 102 cm*	Copë	21
13	**Karroce me rrota per pajisje sterile** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 70 x 70 x 185 cm*	Copë	15
14	**Karroce per sherbime emergjente**	Copë	13
15	**Karroce inoxi me 2 gropa** Dimensione: Min 60x60x90cm Max 70x65x100cm	Copë	7
16	**Karroce furnizimi** Min 95x55x70 cm Max 105x65x80 cm	Copë	18
17	**Stol për dhomat e ndërrimit** Përmasat: Min 100x40x45cm Max 110x50x55 cm	Copë	14

18	**Stol pritje 2 vendesh** Përmasat: Min 107x66x78 cm Max 115x70x83 cm	Copë	11
19	**Stol pritje 3 vendesh** Përmasat: Min 178x66x78cm Max 183x70x83cm	Copë	20
20	**Shkallë ndihmëse për ngjitjen në krevat** Përmasat: Gjatësia: 70 cm Gjerësia: 37 cm; Hapi i parë 70x37x18cm Hapi i dyte 70x37x36	Copë	51
21	**Mobilje inoxi plus lavaman inoxi me 2 gropa** *Dimensione: Min 170x60x75cm Max 180x65x80cm*	Copë	3
22	**Mobilje inoxi plus lavaman inoxi me sirtare** Dimensionet: Min 100x65x85cm Max 140x70x90cm	Copë	1
23	**Mbajtese per veshje dhe doreza e levizshme**	Copë	2
24	**Stol per MRI**	Copë	3
25	**Stativ**	Copë	44
26	**Karroce per persona me aftesi te kufizuar** Gjerësia e sediljes: Nga 55cm deri ne 60 cm Gjerësia e përgjithshme: Nga 76cm deri ne 80 cm Thellësia e përgjithshme: Nga 83cm deri ne 90 cm pa mbështetëse Thellësia e sediljes: Nga 45cm deri ne 50 cm Gjatësia e përgjithshme: Nga 96cm deri ne 100 cm Lartësia e pasme: Nga 45cm deri ne 55 cm Rrotat e përparme: Nga 20cm x 2.5cm deri ne 30 cm x 3.5 cm Rrotat e pasme: Nga 60cm deri ne 70 cm Karroca te jete e pajisur me frena	Copë	8
27	Kosh mbeturinash - jo magnetike (MRI)	Copë	109
28	Kosh mbeturinash	Copë	74

Afatet e lëvrimit: Brenda 2 (dy) muajve duke filluar nga data e nënshkrimit të minikontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër me afat 24 muaj.

LOTI 3: "BLERJE TELEVIZOR DHE FRIGORIFER"

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia matëse	Sasia e pritshme per 24 muaj
1	Frigorifer i vogel (minibar)	Copë	11
2	Televizor	Copë	13

Afatet e lëvrimit: Brenda 2 (dy) muajve duke filluar nga data e nënshkrimit të minikontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër me afat 24 muaj.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

LOTI 1: "MOBILJE DHE PAJISJE PËR PËRDORIM ZYRE DHE AMBJENTE TË TJERA"

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vleres e fondit limit të lotit 1/ shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit 1/ shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- ***a)*** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- ***b)*** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të disponojë stafin me kualifikimet si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri, në rast se operatori ekonomik është prodhues vërtetuar me:
-kontratën individuale të punës (të vlefshme);
-diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh vërtetuar me:
-kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar;

2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:
-kontratën individuale të punës (te vlefshme);

-Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shenim*: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më siper do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, sipas tabeles të lotit 1, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog duhet të tregohen qartë karakteristikat teknike të artikujve të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 "Formulari i specifikimeve teknike".

Nr.	Emërtimi i artikujve
1	**Recepsion ne formë U-je** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Tavolinat e drejta: Min 120x80x105cm Tavolina me hark: Min 80x80x105cm Tavolina e kthimit Min 80x80x75cm, Dimensione: Min 280x200x105cm Max 300x220x120 cm
2	**Dollap medikamentesh me xham** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 100 x 60 x 200 cm*
4	**Raft për dosje, material MDF** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 200 cm
7	**Komo me pasqyrë** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90x 55 x 80 cm
9	**Mobilie qe montohet ne mur, me ndarje dhe celesa per personelin**
10	**Tavolinë pune në formë L-je + Komodinë** Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x h-72 cm Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 160 x 70 x h-68 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm
12	**Tavolinë pune + Komodinë** Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 115 x 70 x 72 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm
14	**Tavolinë e vogël mbledhjesh** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi):180 x 105 x 75 cm
15	**Tavolinë pune rang drejtuesi, material MDF** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 190 x 80 x 76 cm
18	**Tavolinë e veçantë për sallë mbledhjesh** Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 350 x 170 x 75 cm
21	**Mobilje për kuzhinë** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 400x85x75 cm Max 410x90x80 cm

22	**Mobilje me dy sirtare per lavamane** Përmasat: Min 90x60x75cm Max 100x70x85cm
23	**Karrige laboratori**
25	**Karrige për rangun drejtues**
28	**Karrige jo statike me krahë mbështetës**
30	**Stol rrotullues me rregullim lartesie**
31	**Kolltuqe komplet (3+2+1)**
32	**Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)**
35	**Krevat tek** *Përmasat (gjatësi x gjerësi): 190 x 90 cm*

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2: "MOBILJE DHE PAJISJE PËR PËRDORIME SPITALORE"

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të lotit 2/ **shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit 2/ shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për mallat objekt prokurimi sipas tabeles të lotit 2, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog duhet të tregohen qartë karakteristikat teknike të artikullit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Nr.	Emërtimi i artikujve
1	**Dollap metalik me dyer** Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 92 x 40 x 195 cm
4	**Garderobe per personel (2 perdorues / 1 njesi)** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi) Max: 100 x 60 x 200 cm*
7	**Tavoline pune laboratori me lavaman** *Dimensionet :Gjatesi Nga 240 deri 260 cm* *Dimensionet :Gjeresi Nga 85 deri 95 cm* *Dimensionet : Lartesi Nga 75 deri 100 cm*
8	**Tavoline inoksi me 4 rrota** Përmasat: *Min 90x40x80cm Max 100x50x90cm*
10	**Mayo intrumentash** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 75 x 50 x 120 cm*
11	**Karroce inoxi me 2 gropa dhe sirtare**
12	**Karroce per mbajtese ilacesh** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): max 83 x 51 x 102 cm*
13	**Karroce me rrota per pajisje sterile** *Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 70 x 70 x 185 cm*
14	**Karroce per sherbime emergjente**
15	**Karroce inoxi me 2 gropa** Dimensione: Min 60x60x90cm Max 70x65x100cm
16	**Karroce furnizimi** Min 95x55x70 cm Max 105x65x80 cm
21	**Mobilje inoxi plus lavaman inoxi me 2 gropa** *Dimensione: Min 170x60x75cm Max 180x65x80cm*
22	**Mobilje inoxi plus lavaman inoxi me sirtare** Dimensionet: Min 100x65x85cm Max 140x70x90cm
26	**Karroce per persona me aftesi te kufizuar** Gjerësia e sediljes: Nga 55cm deri ne 60 cm Gjerësia e përgjithshme: Nga 76cm deri ne 80 cm Thellësia e përgjithshme: Nga 83cm deri ne 90 cm pa mbështetëse Thellësia e sediljes: Nga 45cm deri ne 50 cm Gjatësia e përgjithshme: Nga 96cm deri ne 100 cm Lartësia e pasme: Nga 45cm deri ne 55 cm Rrotat e përparme: Nga 20cm x 2.5cm deri ne 30 cm x 3.5 cm Rrotat e pasme: Nga 60cm deri ne 70 cm Karroca te jete e pajisur me frena

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 3: "BLERJE TELEVIZOR DHE FRIGORIFER"

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vleres e fondit limit të lotit 1/ shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.4 Kapaciteti teknik:

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit 3/ shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që do të përmbushë specifikimet teknike për artikuj objekt prokurimi të lotit 3 të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	**Përgjigjja**

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	----------
Numri NIPT/et:	----------
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----------
Përfaqësuesi (emri):	----------
Telefoni:	----------
E-mail:	----------

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	**NIPT –i**	**Përqindja e nënkontraktimit**	**Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar**

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	**NIPT-i**	**Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik**	**Specifiko konkretisht kapacitetin/et**

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
